



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**RELACION**

**PROJEKTVENDIM**

**PËR**

**PËRDORIMIN E KODEVE TË SIGURISË PËR PAJISJEN ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT TË ZGJEDHËSVE**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Referuar nenit 14, pika 2, të Kodit Zgjedhor, është parashikuar kompetenca e Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për përcaktimin e zbatueshmërisë dhe drejtimin e punën për zbatimin e projektit të identifikimit elektronik të votuesve. Ai bashkushtron me të drejta të barabarta me komisionerin kompetencat për përzgjedhjen, monitorimin dhe zbatimin e teknologjisë për identifikimin elektronik të zgjedhësve.

Referuar nenit 99, pika 2, shkronja “dh”, të Kodit Zgjedhor, përveç kutive me materialet zgjedhore, sipas pikës 1 të këtij neni, KZAZ-ve u jepen mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, është hartuar projektvendimi “Për përdorimin e kodeve të sigurisë për pajisjen elektronike të identifikimit të zgjedhësve”.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Referuar përcaktimeve të neneve 14 dhe 99, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KQZ dërgon në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), materialet zgjedhore që përdoren nga KZAZ-të për administrimin e procesit zgjedhor dhe materialet zgjedhore për Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit.

Përveç materialeve zgjedhore të listuara në këtë dispozitë, shkronja “dh” e pikës 2 të saj, parashikon edhe dërgimin në KZAZ të mjeteve të tjera të nevojshme për procesin e votimit të cilat sipas projektvendimit, janë kodet e sigurisë të pajisura me “Bar Code” që sigurojnë integritetin e materialeve të cilat do të përdoren për identifikimin e zgjedhësve dhe paprekshmërinë e tyre gjatë transportit në çdo qendër votimi, si dhe lejojnë procesim dhe gjurmim të shpejtë të të dhënave. Thjeshtëzim në përmbylljen dhe dorëzimin e dokumentacioneve duke shmangur efektin bottleneck gjatë procesimit të materialeve.



Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, u propozohet për shqyrtim dhe miratim ky projektvendim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**PËRDORIMIN E KODEVE TË SIGURISË PËR PAJISJEN ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT TË  
ZGJEDHËSVE**

Në mbështetje të nenit 14 pika 2, nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe nenit 99, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës 5, shkronja “e”, të vendimit nr. 2, datë 31.10.2020, të Komisionit Rregullator, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOSIM:

1. Përdorimin e kodeve të sigurisë për mbylljen e çdo komponenti të brendshëm dhe/ose portë komunikimi fizike të Pajisjeve Elektronike të Identifikimit të zgjedhësve (PEI), si dhe për mbylljen e valixhes për transportimin e PEI, nga këtu e vijim referuar si Kodet e Sigurisë PEI.
2. Qëllimi, funksionaliteti dhe karakteristikat e përgjithshme të Kodeve të Sigurisë PEI përshkruhen në Lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Përcaktimi i sasive të Kodeve të Sigurisë PEI, si dhe i kriterëve e specifikimeve teknike të tjera veçmas atyre që përmban Lidhja 1, bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fushën e prokurimeve publike.
4. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



“Për përdorimin e kodeve të sigurisë për pajisjen  
elektronike të identifikimit të zgjedhësve”

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Lealba PELINKU**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Lidhja Nr. 1**

| <b>Materiali zgjedhor</b>            | <b>Përdorueshmëria</b>   | <b>Karakteristika të përgjithshme</b>  | <b>Karakteristika të veçanta</b>  |
|--------------------------------------|--|--|---|
| <b>1.Vulat me Kod sigurie të PEI</b> | Shërbejnë për vulosjen e kompartimenteve të Pajisjes Elektronike të Identifikimit dhe valixhes transportuese të saj përgjatë procesit zgjedhor dhe verifikimit pas-zgjedhor për të garantuar integritetin e pajisjes elektronike të identifikimit dhe komponenteve të saj. | 1) Vulat e sigurisë duhet të jetë rezistente dhe e testuar për një forcë thyerje, tërheqje, përkulje dhe të jetë sipas standardeve të zbatueshme.<br>2) Vulat janë të montueshme me një proces të vetëm pa nevojën e mjeteve ndihmëse.<br>3) Vulat duhet të jenë të projektuara për një përdorim dhe nuk hapen aksidentalisht.<br>4) Çdo përpjekje për të ndërhyrë me anë të ushtrimit të nxehtësisë, forcës mekanike (duke futur një mjet, duke e shpuar, përkulur apo tërhequr) apo kimikateve (tretësve) është e dallueshme nëpërmjet shenjave që lë.<br>5) Ato duhet të jetë rezistente ndaj agentëve atmosferik dhe fizik.<br>6) Ngjyra përcaktohet në varësi të procesit zgjedhor dhe procesit | 1) Vulat e sigurisë do të jenë me qëndrueshmëri këputjeje për të garantuar paprekshmërinë/ mos hapjen aksidentale në çfarëdolloj forme të kutive të votimit.<br>2) Përbërësit e ndryshëm të vulës nuk plasariten, nuk deformohen apo nuk çngjyrosen për shkak të ndryshimeve atmosferike.<br>3) Vula duhet të ketë të shënuar këta elementë:<br>Emri i institucionit: "KQZ". <ul style="list-style-type: none"><li>• Numri serial i vulës i cili është unik, nga 6 deri në 8 shifra</li><li>• Barcodi linear duhet të jetë dhe i qëndrueshëm në trupin e vulës duke siguruar mos fshirjen e tij nëpërmjet fërkimit apo formave të ngjashme, engravim me laser.</li></ul> 4) Numri i shifrave të variojë sipas konsumit, |

Data: Nr:  
Ora:



Për përdorimin e kodeve të sigurisë për pajisjen elektronike të identifikimit të zgjedhësve

|  |  |   |   |
|--|--|---|---|
|  |  | <p>të punës (ngjyrë të veçantë për vulat që do të përdoren për mbylljen e valixhes ose pajisjes dhe ngjyrë të ndryshme për vulat rezerve për secilin rast).</p> | <p>shifrat nuk duhet të jenë të përsëritshme duke përfshirë edhe ato të përdorura më parë.</p> <p>5) Vula që do të përdoret për valixhen duhet të ketë qëndrueshmëri këputjeje e ti rezistojë forcës njëzore.</p> |
|--|--|---|---|